



GROUP FOR LEGAL  
AND POLITICAL  
STUDIES

# Opinion<sup>1</sup>

**Pesë dështimet e Qeverisë në  
rrugën drejt integritimit  
Evropian**

Maj 2019

## PESË DËSHTIMET E QEVERISË NË RRUGËN DREJT INTEGRIMIT EVROPIAN

### AUTOR:

Arbëresha Loxha  
Drejtoreshë Ekzekutive

Grupi për Studime Juridike dhe  
Politike

### PËR GLPS

Grupi për Studime Juridike dhe Politike është institut i pavarur, jo-partiak dhe jo-fitimprurës i politikave publike, me seli në Prishtinë, Kosovë. Misioni ynë është që të realizojmë studime kredibile të politikave në fushën e politikës, së drejtës, dhe ekonomisë, si dhe të avancojmë zgjedhje politikash që adresojnë dështimet dhe/apo trajtuar problemet në fushat e caktuara të politikave.

### - Hyrje

1. Republika e Kosovës vazhdon të përballet me sfida serioze në rrugën e integritit Evropian. Nivelet e këtyre sfidave janë të dyfishta. E para, ajo e pamundësisë politike për tu garantuar që perspektiva Evropiane e Kosovës është e pakontestuar nga çdo shtet anëtar i BE-së, që natyrisht reflekton në mënyrën e vendimmarjes në Këshill të BE-së në raport me çështjet që lidhen me Kosovën. E dyta, mungesa e një përkushtimi minimal të Qeverisë dhe akterëve të tjerë politik për të zbatuar në mënyrë solide reformat e kërkuara nga ajo që tashmë njihet si politikë e zgjerimit e BE-së. Në këtë Shënim Politikash, ne i bëjmë një analizë dështimeve të Qeverisë së Kosovës në vitin 2018 dhe fillim vitin 2019 sa i përket zbatimit të agjendës së integritit Evropian.

2. Mbi këtë bazë, janë pesë fusha ku Qeveria dhe akterët tjerë relevant kanë theks të shtuar të papërgjegjësisë dhe rrjedhimisht dështimet janë më se të vërejtshme.

### - Klientelizmi, madhësia e Qeverisë, menaxhimi abuziv i parasë publike dhe një sektor publik jo-efiqient

3. Sektori publik në përgjithësi vazhdon të jetë i prekur thelbësisht nga dukuria e nepotizmit. Emërimet e larta publike,

përfshirë ato në shërbimin civil por edhe në institucionet e pavarura që i raportojnë Kuvendit, mbesin të kontrolluara nga interesa të ngushta partiake dhe/apo klanore. Një perspektivë e tillë së fundmi është shfaqur në rastin e punësimeve në ndërmarrjen publike Posta dhe Telekom i Kosovës, por jo vetëm. Megjithëse Qeveria duhej t'i përkushtohej një standardi minimal të largimit nga kjo dukuri, ajo jo vetëm që nuk ka dhënë as dëshminë më të vogël që është e përkushtuar ndaj një politike të tillë të integritetit por shpesh ka dalur në mbrojtje të parimit që 'kjo përbën një sjellje normale kur tashmë një zakon i tillë është i etabluar në sistemin publik'. Lufta ndaj klientelizimit dhe nepotizmit është një ndër segmentet më substanciale të kërkesave të politikës së zgjerimit, dhe dështimi i Qeverisë dhe institucioneve gjegjëse për të respektuar atë është tregues i një qasje seriozisht kundër vlerave të procesit integruar.

4. Në anën tjetër, jemi dëshmitar që Kosova përballet me një sektor publik në rritje, me qeverinë me numrin më të madh të dikastereve dhe kabineteve në rajonin e Evropës Jug Lindore, dhe me një shtrirje në rritje të privilegieve për sektorin politik. Një madhësi e tillë e Qeverisë sikur kjo e tanishmja, është reflektim i kënaqjes së appetiteve skandaloze të partnerëve të qeverisë.

Për më tepër, fakti që kjo qeveri përbëhet nga një numër ministrash e zv-ministrash të krahasueshëm me një shtet që është 100-fishi i Kosovës, përbën dëshmi që ajo nuk ka treguar as minimumin e përkushtimit për t'ju përmbajtur kërksave të reformës së administratës publike dhe racionalizimit të procesit të vendimmarrjes.

Mungesa e një ligji për qeverinë, mungesa e zbatimit të një procesi për racionalizimit (zvogëlimin) e agjencive të pavarura dhe e fuzionimit të tyre sipas parimit të efikasitetit, si dhe e një sistemi të rregullave që i sistemon kabinetet politike dhe privilegjet e tyre në një mënyrë të arsyeshme janë të gjitha tregues të një situatë alarmante në sektorin publik. Në anën tjetër, edhe pse struktura e qeverisë do të duhej të ishte koherente, dhe e përballueshme për një koordinim efektiv të politikave publike, ajo vazhdon të jetë e fragmentuar dhe aspak e harmonizuar në vendimmarrje.

Themelimi i trupave të pakuptimtë, sikur koordinatorët e qeverisë, të cilët i kushtojnë buxhetit të

shtetit sasi të konsiderueshme parash, veçse sa e komplikojnë tutje tërë këtë peisazh.

**5.** Menaxhimi i financave publike vazhdon të jetë pre e shkeljeve të standardeve ligjore. Një gjë e tillë vërehet në vendimet e Qeverisë për të shfrytëzuar, përkatësisht keqpërdorur, fondin rezervë. Shumica nga vendimet financiare të Qeverisë në këtë drejtim janë bërë në shkelje të klauzolës së Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike i cili përcakonte kriteret mbi bazën e të cilave mund të bëhet shfrytëzimi i buxhetit rezervë. Në anën tjetër, kalimi i Ligjit për Pagat në Sektorin Publik nga Kuvendi i Kosovës, edhe pse do të duhej të bënte edhe më racional kategorizimin e shërbyesve publike dhe të aplikonte parimin 'kompenzim i njëjtë për punën e njëjtë', në fund u dëshmuar që në fakt veçse e banalizoj tutje një gjë të tillë duke i shtuar buxhetit të Kosovës një ngarkesë shtesë prej 100 milion EUR. Kategorizimet e shërbyesve publik lënë shumë për të dëshiruar, dhe këtu vlen të përmendet mbajtja në fuqi e rritjes së pagave në mënyrë klienteske për sektorin e drejtësisë, që ishte bërë në një mënyrë abuzive nga Kryeministri Haradinaj në Dhjetor të vitit 2017. Në anën tjetër, përballja me dukurinë e falimentimit të PTK-së, dhe paaftësia e Qeverisë për ta futur atë në një proces ristrukturimi sipas standardeve që Komisioni Evropian ia kishte pranuar Kroacisë në rastin (ndër të tjera) e Agrokor, është tregues i faktit që menaxhimi i sektorit publik po bëhet në baza të një anarkie planifikimi dhe mungesë serioze e zvogëlimit të rrezikut me masa parandaluese.

**- Mungesa e një reforme thelbësore në sistemin e drejtësisë dhe ndikimi politik**

**6.** Ndikimi politik në sistemin e drejtësisë mbetet sërish një ndër brengat kryesore në procesin e integritimit Evropian. Qeveria nuk ka bërë asnjë hap konkret në drejtim të një reforme përmbajtësore në sektorin e sundimit të ligjit në vitin 2018 dhe fillim vitin 2019. Edhe pse Qeveria kishte planifikuar një 'kuazi' reformë përmes të ashtuquajturit *rishikimi funksional i sektorit të drejtësisë*, një gjë e tillë nuk ka përfunduar ende dhe as nuk ka dhënë dëshmi të një përkushtimi minimal të asaj që duhet arritur. Mungesa e përkushtimit të Qeverisë për të nisur një proces vettingu në sistemin e drejtësisë të monitoruar ndërkombëtarisht, dhe e një reforme që do të shkëpuste linjën e ndikimit të politikës dhe grupeve të interesit ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të caktuar, përbën një shembull të ngecjes në reformën e sistemit të drejtësisë në procesin e integritimit Evropian. Këshilli Prokurorial dhe Këshilli Gjyqësor vazhdojnë të jenë të paafte për të adresuar në thelb mungesën e vendimeve gjyqësore të prera për figurat e larta publike të cilat janë hetuar ose janë publikisht të denoncuar si të përfshirë në korrupsion apo krim serioz. Në anën tjetër, kultura e mosndëshkueshmërisë dhe mungesa e përgjegjësisë për punën e bërë janë gjithashtu dimensione që po shpërfaqin punën e shumë gjyqtarëve e prokurorëve, por jo vetëm. Kërcënimet publike të Kryeministrit ndaj një prokurori që po hetonte listat e veteranëve ishin ndër të tjera tregues i mënyrës së çfarë prioriteti ka agjenda e sundimit të ligjit në kornizën e qeverisë në Kosovë. Për më tepër, kultura e imunitetit politik ndaj sistemit të drejtësisë po vazhdon me të njëjtin trend, dhe shoqërohet me situata kur ministra të qeverisë që janë të akuzuar për vepra penale vazhdojnë të ushtrojnë

detyrat e tyre në mënyrë të pakontestuar. Barazia para ligjit dhe standardet e integritetit dhe transparencës në vendimmarrjen e institucioneve publike janë tejet problematike, pa përmendur këtu vendimet skandaloze të Qeverisë që i dhanë kompanisë Bektel Enka një shumë 'kinse' kontraktuale prej 53 mil EUR.

**- Një sektor privat me tendencë monopolizimi, një shpërndarje e ç'ardhurave dhe mungesa e një sistemi solid të ruajtjes së konsumatorit**

7. Rritja enorme e sektorit publik, inefiqenca e tij, dhe kompenzimi relativisht më i madh sesa sektori privat, e kanë bërë shumë të vështirë mbijetesën dhe konkurrueshmërinë e sektorit privat. Në anën tjetër, vetëdija jo-korporative e shumë bizneseve, dhe mungesa e incentivave nga Qeveria për t'i shtyer ata drejt ndryshimit të qasjes ndaj rritjes dhe tregut, e bën shumë të vështirë qasjen e bizneseve kosovare në tregjet e huaja por edhe konkurrencën ndaj importit brenda në

Kosovë. Hyrja në fuqi e MSA-së veçse e ka rënduar pozicionimin komod të disa prodhuesve vendor, duke bërë që shumë produkte nga tregu i BE-së të hyjnë me çmime më të lira sesa ato që prodhohen në Kosovë. Në anën tjetër, mungesa e përkrahjes dhe e rritjes së vetëdijes për ngritjen e standardit të prodhimit për bizneset prodhuese, dhe qëndrimi në linjë me standardet e BE-së, sidomos për prodhuesit ushqimor, janë barrierat kryesore në hapjen në tregjet e huaja.

8. Përveç kësaj, është vërejtur një rritje e monopolit të bizneseve të caktuara në treg, në dëm të bizneseve të vogla dhe të mesme. Industria e bizneseve të vogla çdo ditë e më shumë po përballet me barriera mbijetese, dhe e ka të vështirë tejkalimin e kësaj krize të shpërndarjes jo të drejtë të të ardhurave. Kompani sikur Devolli apo shumë të tjera, që kanë shtrirë biznesin në shumë sektorë duke përfutuar kështu edhe nga licenca publike që janë dhënë në mënyrë shpërdoruese sikur ajo për kompaninë virtuale Z-Mobile, janë bërë barrë e rëndë për konkurrueshmërinë dhe ekonominë e tregut që duhet bazuar në rregulla të qarta dhe trajtim të barabartë. Mungesa e fuqisë, dhe e vullnetit, të Autoritetit të Konkurrencës për të imponuar një qasje të bazuar në legjislacionin e konkurrencës shoqërohet me tendencën e Qeverisë për t'i ruajtur klientelat në bizneset e mëdha ekzistuese. E tërë kjo po ndikon në një sistem të tregut të punës që është i kontrolluar nga të 'fortit', shthurje të biznimit të vogël dhe të mesëm, dhe eksploatim të padrejtë të fuqisë punëtore në sektorin privat. Në anën tjetër, mbrojtja e konsumatorit vazhdon të jetë një fushë ku nuk është ndier ende dora e Qeverisë.

**- Sistemi arsimit i bazuar në premisa të nën-rregullimit, mungesës së kualitetit dhe konkurrueshmërisë me rajonin dhe më gjerë**

9. Qeveria vazhdon ta shfrytëzoj diskrecionin e saj për t'i ushqyer interesat e saj klienteske përmes sistemit të arsimit të lartë, si atij privat ashtu edhe atij publik. Gjatë këtyre viteve, Qeveria nuk kishte vullnetin të ndërmerre një strategji të reformës substanciale të sistemit të arsimit të lartë, për t'ia kthyer atij kredibilitetin dhe cilësinë e kërkuar. Universitetet e shumta nëpër çdo regjion të Kosovës, që bartin programe arsimore pa ndonjë vlerë në tregun e punës dhe që nuk plotësojnë kërkesat e konkurrueshmërisë, janë karakteristika të padiskutueshme të tyre. Në anën tjetër, rritja enorme e numrit të programeve të kolegjeve private, e shoqërojnë natyrshëm skenarin e shkatërrimit të cilësisë së arsimit të lartë. Për të mos u përmendur, shumë kolegje private apo universitete regionale vazhdojnë të kenë të punësuar figura të larta politike e publike, duke të dhënë kështu përshtypjen e një ambienti klienteske. Një përbërje e tillë është natyrisht e paaftë për të përmirësuar cilësinë e shkathtësive të punëtorëve në tregun e punës, dhe aftësinë e të shkolluarve në Kosovë për të eksportuar shërbimet e tyre në tregjet e huaja.

10. Në anën tjetër, Agjencia e Akreditimit e Kosovës humbi statusin e saj në Listën Evropiane EQAR, dhe ju rrezikuar anëtarësia e saj në ENQA. Vendimet e Agjencisë shpeshherë të lënë shijen e një procesi që, edhe pse proceduralisht i rregulluar, nuk ka qëllim të vërtetë të garantoj një cilësi esenciale në tregun e arsimit të lartë. Në anën tjetër, mungesa e arsimit profesional, dhe paaftësia e Qeverisë për ta futur atë

si pjesë esenciale në mekanizmin e tregut të punës, veçse e bëjnë më të vështirë që të rinjtë e shkolluar në Kosovë t'i përshtaten kërkesave të industrive shërbyese dhe prodhuese në rajon dhe jashtë Kosovës. Nuk duhet lënë pa përmendur edhe numrin e madh të të emëruarve me prejardhje partiake nëpër bordet udhëheqëse të universiteteve publike, e tërë kjo shenjë e një kontrolli të tepruar politik mbi sistemin publik të arsimit të lartë. E gjithë kjo është dëshmi që Qeveria nuk kishte përkushtimin minimal për të filluar një reformë serioze në sistemin e arsimit të lartë që qëllim do të kishte rritjen e cilësisë, sigurinë dhe kualitetin e marrjes së titujve, garantimin e përshtatjes së mësimi me nevojat e tregut bashkëkohor dhe, më së shumti, forcimin e sistemit të luftës ndaj abuzimit në sistemin e arsimit të lartë.

*- Një tendencë në rritje e migrimit si rezultat i imazhit në rënie të institucioneve publike dhe mungesës së barazisë para ligjit*

**11.** Migrimi është një dukuri në rritje në tërë rajonin e Ballkanit

Perëndimor, ndaj të cilës nuk ka qëndruar imune as Kosova. Dëshira për të gjetur një vend pune në një shtet të Bashkimit Evropian është në rritje në Kosovë, megjithëse tashmë ajo shoqërohet vetëm me kërkesën që ajo të jetë brenda kornizës së një migrimi të ligjshëm. Rritja e kërkesës për ta lënë Kosovën është dëshmi e një pasigurie me trajtimin në tregun e punës, dhe imazhin në rënie të Qeverisë dhe institucioneve publike. Aferat e shumta të Qeverisë dhe të sektorit publik në përgjithësi, dhe paaftësia e qytetarëve për tu përballur me sfidat e një sistemi që ka kufizime në qasje, e bëjnë dëshirën për të ikur në rritje në Kosovë. Tendencat në rritje e dëshirës për të migruar megjithatë kërkon një qasje serioze të Qeverisë, që lidhet para së gjithash me një dëshmi që në Kosovë ka shpresë për një sistem më të mirë publik, dhe me një perspektivë që shkon përtej kornizave partiake e klienteske. Qeveria nuk dëshmoi në asnjë rast në vitin 2018 dhe fillim vitin 2019 që ajo gëzonte aftësinë për tu përballur me këtë ëështje, dhe as që ka ndërmarr ndonjë veprim strategjik për ta planifikuar një politikë që e parandalon një gjë të tillë.

**12.** Dështime e listuara dhe trajtuara me lartë kanë të përbashkët mungesën e vullnetit dhe përkushtimit të vendimmarrësve dhe përfaqësuesëve politik për të zbatuar me sukses reformat nevojshme në kuadër të politikës së zgjerimit të BE-së. Kosova vazhdon të përballet me probleme thelbësore në funksionimin e mirëfilltë të pothuajse secilës sferë publike, dhe rëndom progresi potencial shndërrohet në regres të parashikuar.

**13.** Përbërja dhe rregullimi aktual i sistemit të drejtësisë e bënë atë të paaftë, shpesh herë edhe për shkak se është krykëput i ndikuar, në luftimin e

suksesshëm të korrupsionit, krimin, nepotizmit dhe keqpërdorimit aktiv të pozitave dhe parasë publike. Në vend se të kontribuoj në përmirësimin e kësaj gjendje, Qeveria aktuale vetëm sa e ka e përkeqësuar atë. Në anën tjetër, zhvillimi ekonomik vazhdon të jetë peng i një sektori privat cdo herë e më shumë të monopolizuar, dhe një tregu të punës i cili ndonëse aspak favorizues ballafaqohet me shpërputhje të theksuar të kërkesave të tregut dhe përgatitjes profesionale të fuqisë punëtore, përgjegjësi të cilën kanë dështuar ta plotësojnë institucionet e arsimit të lartë. Si rezultat, migrimi, ndonëse kësaj radhe brenda suazave të migrimit të ligjshëm, është rikthyer si shqetësim kombëtar që sinjalizon qartë pakënaqësitë e qytetarëve me mënyrën e qeverisjes në vend.

**14.** Prandaj, aspirata për anëtarësim të plotë të Kosovës në Bashkimin Evropian nuk mund të arrihet për aq kohë sa qëllimi përfundimtar i kësaj Qeverie dhe qeverive të tjera është vetëm bindja e kontrolluar dhe selektive ndaj kërkesave të përfaqësuesëve të BE-së, e jo Evropianizimi i Kosovës nëpërmjet përbrendësimit të reformave dhe vlerave të Bashkimit Evropian.

**OPINIONET**

Opinionet dhe komentet janë publikime që përmbajnë analiza nëpërmjet së cilave ne reflektojmë pozicionin tonë ndaj një politike të caktuar në publik, apo janë kontribute të ekspertëve ndërkombëtar mbi çështje relevante për ne. Në parim, opinionet janë qëndrime të autorëve dhe jodomosdoshmërisht janë qëndrime të Grupit për Studime Juridike dhe Politike.



Grupi për Studime Juridike dhe Politike  
Adresa: Rr. 'Rexhep Luci' 16/1  
Prishtina 10 000, Kosovë  
Ueb-faqja: [www.legalpoliticalstudies.org](http://www.legalpoliticalstudies.org)  
E-maili: [office@legalpoliticalstudies.org](mailto:office@legalpoliticalstudies.org)  
Tel/fax.: +381 38 234 456